



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

## Drejtoria Komunale e Arsimit

Datë: 18.8.2023  
Vendi: Rahovec  
Nr. i ref.: 04/1109  
Drejtori: Avni Morina



Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, i Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-032, të datës 29.8.2011, neni 34 dhe 35, të Ligjit për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, Nr. 05/2021, për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, shpall:

### KONKURS

Për plotësimin e një (1) pozite të lirë të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2023/2024: Mësimdhënës/e për lëndët e profilit Bujqësor, në:

➤ IAAP "Selajdin Mullaabazi-Mici", në Rahovec

#### I. Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët/et për të marrë pjesë në konkurs:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional sipas U.A. 05/2021, Udhëzimit Administrativ për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

#### II. Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar;
- Kopjet e çertifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë;
- Kopjen e ekstraktit të lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime.

#### III. Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret/shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>

#### IV. Lista Pritëse:

Kandidatët të cilët grumbullojnë më shumë se 50 pikë, hynë në listën pritëse si kandidatë fitues, dhe nëse paraqitet nevoja për ndonjë pozitë të lirë si Mësimdhënës/e për lëndët e profilit Bujqësor, kanë të drejtë të punësohen.

#### V. Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.

#### VI. Aplikimi në konkurs:

Afati i aplikimit fillon nga data 18.9.2023 dhe zgjat 8 ditë kalendarike, me datë 25.9.2023, deri në orën 16:00.